



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.SH.II.nr.1132/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit NPN Teknika Projekt me seli në Mushtisht Komuna e Suharekës, me pronar Q.S., të cilin me autorizim e përfaqëson Miftar Qelaj avokat nga Suhareka, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati komunal Afrim Bytyqi në Suharekë, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit KE.nr.1010/22 datës 02.06.2023 i Gjykatës Komerciale tq Kosovës-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e të paditurës Komuna e Suharekës, PRISHET Aktgjykimi KE.nr.1010/22 i datës 02.06.2023 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, dhe Lënda i kthehet të njëjtës, në rigjykim dhe rivendosje

A r s y e t i m

Dhoma e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, KE.nr.1010/22 i datës 02.06.2023, në dispozitivin e aktgjykimit ka vendosur: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NPN Teknika Projekt me seli në Mushtisht Komuna e Suharekës, e parashtuar kundër të paditurës Komuna e Suharekës, II. Detyrohet e paditura Komuna e Suharekës, që paditësit NPN Teknika Projekt me seli në Mushtisht Komuna e Suharekës, t,ia kompensoj dëmin e shkaktuar për shkak të vonesave në pagesë, mos evitimin e pengesave për realizimin e punimeve sipas kontratës si dhe fitimin e humbur për shkak të shkëputjes s njëanshme të kontratës me numër prokurimit 624-12-064-521 datës 06.07.2012 për ndërtimin e rrugës në fshatin Matiqevë dhe atë në lartësi prej 69,039.53€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, III. Obligohet e paditura Komuna e Suharekës t,ia kompensoj paditësit NPN Teknika Projekt me seli në Mushtisht Komuna e Suharekës, të gjitha

shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë dhe atë në lartësi 1,204.00€ në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur, e cila e kundërshton aktgjykimin e atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, me propozimin që ankesa të aprovohet, të prishet aktgjykimi KE.nr.1010/22 i datës 02.06.2023, dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi NPN Teknika Projekt me seli në Mushtisht Komuna e Suharekës, me datën 23.05.2014 ka parashtruar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, padi, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, për shkak të borxhit dhe kompensimin e dëmit pas shkëputjes së kontratës. Me padi paditësi kërkon nga gjykata të detyrohet e paditura t,ia kompensoj dëmin e shkaktuar për shkak të shkëputjes së një anshme të kontratës sipas numrit prokurimit 624-12-064-521 për ndërtimin e rrugës Matiqevë.

Dhoma e shkallës së parë, duke vepruar sipas aktvendimit Ae.nr.224/2019 dt.15.09.2020 të Gjykatës së Apelit, ka caktuar seancën gjyqësore me datën 24.04.2023 në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe ka nxjerr aktgjykimin e atakuar me të cilin ka aprovuar në tërsi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit theksohet se gjykata vërtetoi se shkëputja e njëanshme e kontratës nga ana e të paditurit është parapa në pikën 26 të kontratës. Deri në shkëputjen e kontratës paditësi ka kryer 12% të shumës së kontraktuar prej 210,54.68€. Gjykata ia ka falur besimin ekspertizës financiare e cila në përmbajtjen e saj nuk ka mangësi, paqartësi apo kontradikta eventuale, andaj ka konstatuar lartësinë e dëmit të shkaktuar të cekur në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata vendimin e mbështet në dispozitat e nenit 106, 114, 136, 173 dhe 174 të LMD-së,

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, sipas detyrës zyrtare, e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 të LPK-së, dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhoma e Shkallës së dytë, ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika (n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsye

për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe dokumenteve të administruara si prova.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, ka vlerësuar se arsyetimi i aktgjykimit është i mangët në drejtim të vërtetimit të gjitha fakteve vendimtare që kanë ndikim në vendosjen e kësaj çështje kontestimore. Dhoma e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, duke mos vlerësuar edhe provat e tjera të lëndës, të cilat veprime i kanë paraprij Njoftimit për shkëputjen e kontratës nga i padituri me datën 17.06.2014, si dhe pretendimet e të paditurit gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor sa i përket kostos së makinerisë në kryerjen e punimeve respektivisht kontratat për qiradhënie, të marra për bazë nga eksperti financiar, duke anashkaluar këto fakte vendimtare, që mund të kenë ndikim në zhvillimin e këtij kontesti. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale.

Dhoma e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit nuk vlerëson fare kërkesat e paditurit drejtuar paditësit, për fillimin e punimeve në projektin e kontraktuar ndërtim i rrugës në fshatin Matiqevë, nr.prokurimit 624-12-064-521, aktin përcjellës si vërejtje e fundit për vazhdimin e punimeve dt.07.03.2013, të cilat prova i kanë paraprij Njoftimit për shkëputjen e kontratës datës 17.06.2014, fakte këto të cilat janë relevante në krijimin e bazës juridike të përgjegjësisë mos përmbushje të kontratës.

Kolegji vlerësoi, se nga provat që ka administruar dhoma e shkallës së parë, janë të pasakta dhe të mangëta provat që kanë të bëjnë me ekzekutimin e punëve të kryera deri në shkëputjen e kontratës nga e paditura, pasi që sipas Raportit datës 29.07.2013 nga Mbikëqyrësi i projektit NPN Eng Idea –Suharekë, kanë mbetur punë të pa kryera në vlere prej 26,950.1€ apo 12.8% e vlerës së kontratës, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit thuhet se paditësi ka kryer 12% të shumës së kontraktuar prej 210,54.68€, që del se kjo vlerë është 26,950.10€, prandaj këto vlerësime në aktgjykim janë krejtësisht kontradiktore me gjendjen faktike.

Kolegji gjithashtu vlerësoi se dhoma e shkallës së parë nuk ka provuar ti vërtetoj pretendimet e të paditurit gjatë procesit gjyqësor dhe të shqyrtoj vërtetësinë e tri Kontratave për qiradhënie dhe qiramarrje të makinerisë të angazhuara në kryerjen e punimeve sipas projektit, në të cilat eksperti financiar është referuar me rastin e llogaritjes së kostos së lartësisë së dëmit të shkaktuar për shkak të pritjes në kryerjen e punimeve. Kolegji vlerësoi se këto kontrata kanë të bëjnë me kryerjen e punëve ndërtimore në projekte tjera të ndryshme, e që nuk mund të vërtetohet se pajisjet teknike nga këto kontrata kanë qenë të përfshira në ndërtimin e projektit - ndërtimi i rrugës në fshatin Matiqevë me numër prokurimit 624-12-064-521.

Dhoma e Shkallës së Dytë, nga provat që ka administruar dhoma e shkallës së parë, tani për tani nuk mund të vlerësoj të drejt aktgjykimin e atakuar, se i njëjti gjen mbështetje në dispozitat e nenit 136 par.1 të LMD-së, sa i përket përgjegjësisë për mos përmbushjen e kontratës së prokurimit, dhe në anën tjetër mos vërtetimi i gjendjes faktike rezulton nga fakti në seancën gjyqësore nuk është ftuar dhe ballafaquar eksperti financiar lidhur me punimin e ekspertizës financiare datës 14.06.2017, për të vërtetuar saktë provat e referuara në punimet e kryera të projektit nga ana e paditësit.

Duke u nisur nga kjo gjende e tillë e çështjes, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, ka gjetur se tani për tani, nuk mund të pranohet konkludim juridik i dhomës së shkallës së parë, si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për shkak të mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale, prandaj është dashur që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda ti kthehet Dhomës së shkallës së parë në rigjykim.

Në ri-procedurë, Dhomat e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe me arsyet e theksuara për çështjet kryesore dhe sipas nevojës përmes plotësisht të ekspertizës financiare, apo nxjerrjes së ekspertizës së re, të nxjerrë provat e nevojshme për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ta vërtetojë drejt përgjegjësin e palës në mos përmbushjen e kontratës së prokurimit, dhe pas kësaj nëse konstaton se ndonjëra palë ka pësuar dëm, ta vlerësojë dëmin real dhe të marrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.SHh.II.nr.1132/23 datë 04.04.2024

Kryetari i Kolegjit
Krenar Berisha